

UDHËRRËFYESI I SUPERNDRYSHUESVE

PËR ZHVILLIM TË KOMUNITETIT



USAID
NGA POPULLI AMERIKAN
OD AMERICKOG NARODA





USAID
NGA POPULLI AMERIKAN
OD AMERICKOG NARODA



UDHËRRËFYESI I SUPERNDRYSHUESVE PËR ZHVILLIM TË KOMUNITETIT



Korrik 2016



Udhërrëfyesi i Superndryshuesve për Zhvillim të Komunitetit
Të drejtat e autorit © 2016 Fondacioni Ndërkombëtar për Sisteme
Zgjedhore.
Të gjitha të drejtat janë të rezervuara.

Deklarata e lejes: Asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të riprodhohet në asnjë formë ose në asnjë mënyrë, elektronike ose mekanike, përfshirë fotokopjimin, regjistrimin, ose me ndonjë sistem për ruajtje dhe nxjerrje të informatave pa lejen me shkrim të IFES-it.

Në kërkesat për leje duhet të përfshihen informatat e mëposhtme:

- Përshkrimi i materialit për të cilën dëshirohet leja për kopjim.
- Qëllimi për të cilin do të përdoret materiali i kopjuar dhe mënyra në të cilën ai do të përdoret.
- Emri juaj, titulli, emri i kompanisë ose i organizatës, numri i telefonit, numri i faksit, adresa e emailit dhe adresa e postës.

Ju lutemi që të gjitha kërkesat për leje t'i dërgoni në:

International Foundation for Electoral Systems
2011 Crystal Drive, Floor 10
Arlington, VA 22202
Email: editor@ifes.org
Fax: 202-350-6701

Ky udhërrëfyes është mundësuar nga përkrahja bujare e popullit amerikan përmes Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID). Opinionet e shprehura në këtë raport janë të autorit(ëve) dhe jo domosdoshmërisht i pasqyrojnë pikëpamjet e USAID-it ose të Qeverisë së Shteteve të Bashkuara.

UDHËRRËFYESI I
SUPERNDRYSHUESVE
PËR ZHVILLIM TË KOMUNITETIT



Pasqyra e përmbajtjes

6	Përkufizimet	
7	Mirësevini	
9	FAZA I: PJESËTAR	
10	FAZA II: AKTIV	
17	FAZA III: SUPERAKTIV	
22	FAZA IV: NDRYSHUES	
29	FAZA V: NDRYSHUES SOCIAL	
36	FAZA VI: SUPERNDRYSHUES	
41	INKUBATORI I NJOHURIVE TË SUPERNDRYSHUESVE	
41	PJESA 1: KORNIZA PËR ZGJEDHJE	
47	PJESA 2: ADMINISTRIMI I ZGJEDHJEVE	
50	PJESA 3: ÇFARË BËN ADMINISTRATA ZGJEDHORE?	
60	PJESA 4: RUAJTJA E INTEGRITETIT TË ZGJEDHJEVE	
63	PJESA 5: SUBJEKTET POLITIKE	
65	PJESA 6: INSTITUCIONET E QEVERISJES NË KOSOVË	

UDHËRRËFYESI I
SUPERNDRYSHUESVE
PËR ZHVILLIM TË KOMUNITETIT





Përkufizimet

.....

SUPERNDRYSHUES/E - emër

Person i ri me aftësi të shkëlqyeshme për të adresuar çështje në komunitetin e tij/saj, duke ofruar zgjidhje kreative, me entuziazëm e përkushtim për të kontribuar drejt përmirësimeve në vendin e tij/saj.

SUPERFUQI - emër

Njohuri, aftësi e shkathtësi që u mundësojnë SUPERNDRYSHUESVE të bëjnë ndryshimet që i konsiderojnë të nevojshme për ta bërë Kosovën vend më të mirë.

...

Falë **SUPERNDRYSHUESVE** në gjithë botën, vendet kanë ecur përpara. Ata janë superheronjtë e kohës së sotme, që nuk luftojnë, por zhvillojnë komunitete e ndërtojnë të ardhme. Ata janë njerëzit tek të cilët Kosova llogarit për të arritur potencialin e saj të plotë, ashtu që secili që jeton këtu të ndjehet i lumtur si pjesëtar i vlerësuar i komunitetit.



Mirësevini

Ti

Po, ti

**A e di se sa i/e vlefshëm/vlefshme
je për komunitetin tënd?**

Po, po ti!

**E tash, bëhu gati për të nisur udhëtimin
për t'u bërë SUPERNDRYSHUES.**

Si pjesëtar/e i/e ri/re i/e komunitetit tënd, plot energji e dëshirë për të mësuar, ti ke fuqinë të bësh gjëra të mëdha për vendin tënd. E tëra që të duhet, bashkë me vullnetin, është identifikimi e përforcimi i superfuqive tuaja.

Ky udhërrëfyes do të të ndihmojë të gjesh fuqitë dhe dobësitë tuaja, të përforcosh tërësinë e shkathtësive tuaja, dhe do të jep njohuri për proceset zgjedhore e politike, si dhe për zhvillimin e udhëhequr nga të rinjtë. Gjatë këtij udhëtimi, do të kalosh në gjashtë faza.



ANËTAR/E
Faza fillestare

Ti je anëtar/e i/e vlerësuar i/e shoqërisë thjesht me ekzistencën tënde.



AKTIV/E
Faza e vetë-vlerësimit

Hapi i parë drejt përforcimit të superfuqive dhe zotërimit të fuqive të reja është përmes vlerësimit të shkathtësive aktuale dhe identifikimit se çfarë mund të përmirësoni brenda vetës.



SUPERAKTIV/E
Faza e qytetarit aktiv

Disa prej mënyrave më themelore të angazhimit në procese të rëndësishme për vendin janë votimi, punësimi në organe zgjedhore, pjesëmarrja në debate publike komunale, e të tjera.



NDRYSHUES/E
Faza e ndryshuesit në nivel makro

Përfshirja në procese politike, ose përmes subjekteve politike ose përpjekjeve të pavarura, që ju mundëson të fitoni pozitën për të zhvilluar politika e për të zbatuar zgjidhje që arrijnë tek qytetarët e Kosovës, ose kanë ndikim të drejtpërdrejtë tek ta.



NDRYSHUES/E TË SHOQËRISË
Faza e zhvilluesit/es të komunitetit

NDRYSHUESIT E SHOQËRISË shpesh duan të punojnë larg nga vëmendja, si dhe bëjnë punë të shumta të rëndësishme në përmirësim të komuniteteve të tyre, përmes aktiviteteve të ndryshme, që kryesisht janë vullnetare.



SUPERNDRYSHUES/E
Faza e superfuqisë me forcë të plotë

Kuptimi i proceseve dhe kontribuimi në disa prej këtyre fazave përforcon superfuqitë tuaja, përmes të cilave jo vetëm që do të bëheni SUPERNDRYSHUES/E, por do të jeni të pandalshëm.

Pra, me entuziazmin dhe idealet tuaja, çojë deri në fund udhëtimin drejt të qenit SUPERNDRYSHUES/E, si dhe përdor superfuqitë tua për ta bërë Kosovën vend më të mirë për të gjithë ne.

**Ne llogarisim
në ty!**



FAZA I: ANËTAR/E

FAZA FILLESTARE

Ti je anëtar/e i/e komunitetit dhe shoqërisë tënde, thjesht me ekzistencën tënde. Si anëtar/e, ke të drejta që gëzon dhe përgjegjësi për të kontribuar në zhvillimin e vendit tënd dhe përforcimin e demokracisë.



Zëri yt ka
rëndësi.

Kontributi yt
ka vlerë.

Idetë tuaja janë
të rëndësishme.

Ti
kenjë rol.

Përmirësimi i komunitetit tënd, shoqërisë tënde, e përfundimisht edhe vendit tënd, varet nga ti.

FAZA II:


AKTIV

FAZA E VETË-VLERËSIMIT

Superndryshuesit/et zhvillojnë superfuqitë e tyre duke përfurcuar pikat e forta e duke i pëmirsuar dobësitë. Për këtë arsye, hapi i parë drejt të qenit Superndryshues/e është vetë-vlerësimi, që të ndihmon të zbulosh pikat e forta dhe të dobëta, si dhe fushat në të cilat mundesh me qenë më i/e fortë dhe më i/e mirë.

Në vijim mund të gjeni një test vetë-vlerësues të dizajnuar për të ndihmuar në këtë proces. Testi është ndarë në kategori, ku secila paraqet karakteristika personale. Ekzistojnë 11 kategori që kontribuojnë në zhvillimin personal të Superndryshuesve. Janë aty gjithsej 33 fjali që të ndihmojnë të vlerësosh veten në kategori specifike dhe të përgjithshme.

Jepini notë secilës fjali prej 1 (aspak nuk lidhet me mua) deri në 5 (mu si unë), në bazë të asaj se sa janë të vërteta ato për ty.



KATEGORIA

DEKLARATA

AFTËSITË KOMUNIKUESE

Komunikoj qartë dhe efektivisht
me të tjerë, pa rrotulla.

1 2 3 4 5

☐ ☐ ☐ ☐ ☐



Dëgjoj të tjerët dhe përpunoj atë që
e thonë, para se të përgjigjem.

1 2 3 4 5

☐ ☐ ☐ ☐ ☐



Kur kam ndonjë çështje me personin tjetër,
e diskutoj me të dhe e trajtoj.

1 2 3 4 5

☐ ☐ ☐ ☐ ☐

KURAJO

Luftoj për atë që e besoj, pa marrë parasysh
se sa e vështirë është situata.

1 2 3 4 5

☐ ☐ ☐ ☐ ☐



Ngre zërin në përkrahje të të tjerëve kur ata
lëndohen apo trajtohen padrejtësisht.

1 2 3 4 5

☐ ☐ ☐ ☐ ☐



Punoj fort për ëndrrat e mia edhe
nëse janë tepër të mëdha.

1 2 3 4 5

☐ ☐ ☐ ☐ ☐



KATEGORIA

DEKLARATA

KREATIVITETI

Kur përballem me një problem, kërkoj jashtë kornizës për të gjetur zgjidhje të mundshme.

1 2 3 4 5

☐ ☐ ☐ ☐ ☐



Nuk përdor zgjidhje shabllon.

1 2 3 4 5

☐ ☐ ☐ ☐ ☐



Kam ide të ndryshme për zgjidhjen e një problemi.

1 2 3 4 5

☐ ☐ ☐ ☐ ☐

TË MENDUARIT KRITIK

Kur dëgjoj mediat, marr parasysh animet e mundshme.

1 2 3 4 5

☐ ☐ ☐ ☐ ☐



Analizoj vetë të gjitha informatat që marr dhe krijoj mendim në bazë të saj.

1 2 3 4 5

☐ ☐ ☐ ☐ ☐



Mundohem të mësoj më shumë se sa di në të gjitha fushat.

1 2 3 4 5

☐ ☐ ☐ ☐ ☐



KATEGORIA

DEKLARATA

NDJESHMËRIA

Mundohem ta vë veten në pozitën e tjetrit.

1	2	3	4	5
☐	☐	☐	☐	☐



Trajtoj njerëzit ashtu siç dua të më trajtojnë.

1	2	3	4	5
☐	☐	☐	☐	☐



Mundohen të ndihmoj njerëzit kur përballen me sfida.

1	2	3	4	5
☐	☐	☐	☐	☐

ENTUZIAZMI

E dua fushën e studimeve/punës ku jam, lexoj shumë për të.

1	2	3	4	5
☐	☐	☐	☐	☐



Jam shumë i/e zellshëm/zellshme në aktivitete, më pëlqejnë shumë.

1	2	3	4	5
☐	☐	☐	☐	☐



Më pëlqen të flas me të tjerë për atë që studioj/punoj.

1	2	3	4	5
☐	☐	☐	☐	☐



KATEGORIA

DEKLARATA

INTEGRITETI

Jam i/e sigurtë në kontaktet
me të tjerë.

1	2	3	4	5
☐	☐	☐	☐	☐



Etika është e rëndësishme në sjelljen
dhe studimet/punën time.

1	2	3	4	5
☐	☐	☐	☐	☐



Trajtoj të gjithë drejt.

1	2	3	4	5
☐	☐	☐	☐	☐

LIDERSHIPI

Marr iniciativën kur shoh që mund të
bëhet ndryshimi në komunitetin tim.

1	2	3	4	5
☐	☐	☐	☐	☐



Në ekip, prirem të udhëheq
punën që duhet të kryhet.

1	2	3	4	5
☐	☐	☐	☐	☐



Motivoj të tjerët dhe i frymëzoj të bëjnë
më të mirën në punën e tyre.

1	2	3	4	5
☐	☐	☐	☐	☐



KATEGORIA

DEKLARATA

BESNIKËRIA

Jam i besueshëm dhe mbaj të fshehta informatat që më janë dhënë vetëm mua.

1	2	3	4	5
☐	☐	☐	☐	☐



Përkrah miqtë apo organizatën time edhe në situatat më të vështira.

1	2	3	4	5
☐	☐	☐	☐	☐



Jam i përkushtuar në çdo gjë që bëj.

1	2	3	4	5
☐	☐	☐	☐	☐

KËMBËNGULËSIA

Vazhdoj të provoj, edhe nëse dështoj disa herë.

1	2	3	4	5
☐	☐	☐	☐	☐



Dështimi në një detyrë nuk do të thotë që jam dështim komplet. Do të thotë që ka mënyra që duhet t'i provoj.

1	2	3	4	5
☐	☐	☐	☐	☐



Kur vërtet besoj që diçka është e drejtë, vazhdoj të theksoj argumentet e mia.

1	2	3	4	5
☐	☐	☐	☐	☐



KATEGORIA

DEKLARATA

BESUESHMËRIA

Kur marr detyrën, e kryej
më së miri që di.

1 2 3 4 5



Qëndroj i/e gatshëm/gatshme për miqtë
e kolegët e mi, kurdo që ka nevojë.

1 2 3 4 5



Eprorët e mi mund të llogarisin
në punën time cilësore.

1 2 3 4 5



NOTA TOTALE



Fushat ku keni dhënë notën ndërmjet 1 dhe 2 janë fushat ku duhet të përmirësoheni, ato me notën 3 dhe 4 janë fushat ku karakteristikat/aftësitë tuaja do të mund të përforcoheshin, derisa ato që kanë notën 5 tashmë tregojnë që i keni ato karakteristika të Superndryshuesve. Nota e përgjithshme e lartë tregon që keni më shumë superfuqi, si dhe që tashmë jeni duke ndryshuar komunitetin e shoqërinë e gjerë, hap pas hapi.

FAZA III:

SUPERAKTIV/E

FAZA E QYTETARIT AKTIV


Tashmë je gati të bëhesh Kosovar/e SUPERAKTIV/E, agjent/e i/e ndryshimit për shoqërinë e Kosovës.

Si mund të përdorësh këto fuqi me efektin më të madh?

Kosova mban zgjedhje të rregullta për përfaqësuesit tuaj në nivelin komunal – për kuvendet dhe kryetarët e komunave, si dhe në nivel shtetëror, për Kuvendin e Kosovës. Për të qenë i/e sigurt që fjala jote ka peshë në zhvillimin e Kosovës, ti duhet të votosh.

Zgjedhjet janë aktivitet i të gjithë vendit, ku secili ka një rol të caktuar – nga votimi deri në garim për zgjedhje deri tek organizimi dhe administrimi i zgjedhjeve për të siguruar drejtësinë dhe integritetin e procesit zgjedhor.

Pasi që përfaqësuesit e zgjedhur nga ju të marrin mandatin, mund të monitorosh aktivitetet e tyre deri në zgjedhjet e radhës. Kjo do të ndihmojë në kërkimin e llogarisë për zbatimin e programeve në dobi të popullit në Kosovë, si dhe ndihmon për të vendosur për kë të votosh në zgjedhjet vijuese.



A E KENI DITUR?

Në çdo palë zgjedhje, KQZ-ja punëson rreth 17,000 deri në 19,000 njerëz si personel zgjedhor dhe akrediton rreth 20,000 vëzhgues zgjedhjesh.

**TI MUND TË JESH
NJËRI NGA ATA/ATO.**

○ Kërkoni llogari nga përfaqësuesit tuaj të zgjedhur

Të gjithë qytetarët e Kosovës kanë të drejtë vote sapo të mbushin 18 vjeç. Përmes votimit në zgjedhje, ke fuqinë për të marrë vendime në një nivel shumë më lart sesa jeta jote – mund të ndikosh drejtpërdrejt në vendimet që merren për të gjithë Kosovën.

Me secilën votë, zgjedhja jote vërehet, e zëri yt dëgjohej. Me votim, ke fuqinë të kërkosh llogari nga përfaqësuesit e zgjedhur për punët që ata bëjnë. Nëse beson që kanë punuar mirë, mund të vendosni të vazhdoni përkrahjen për ata/ato, e nëse jo, mund të zgjedhni të votoni për dikë tjetër.

Më me rëndësi, ti ke një zgjedhje, e ajo zgjedhje është krejtësisht e jotja.

Dëshiron të dish më shumë për kornizën e zgjedhjeve në Kosovë? Shko tek INKUBATORI I NJOHURIVE PËR SUPERNDRYSHUES/E, Pjesa 1, faqe 41.



Kontributi në sigurimin e menaxhimit të mirëfilltë të zgjedhjeve

Mund të ndihmosh në menaxhimin e zgjedhjeve, duke u angazhuar si staf i zgjedhjeve në një vendvotim apo si staf në aktivitete tjera zgjedhore, si në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve, ku definohen rezultatet e zgjedhjeve. Suksesi i zgjedhjeve varet shumë nga puna e mijëra punëtorëve zgjedhorë që implementojnë procesin e zgjedhjeve.

Para, gjatë dhe pas ditës së zgjedhjeve, institucionet që menaxhojnë zgjedhjet kanë shumë detyra për të kryer. Edhe nëse nuk punon si zyrtar/e i/e zgjedhjeve, ka gjëra që mund të bësh për të siguruar që zgjedhjet të jenë reflektim i pastër i zërit të popullit.

Ti mund:

- Të sigurosh që ti, familja dhe miqtë e tu të jenë të regjistruar siç duhet për të votuar
- Të sigurosh që ti, familja dhe miqtë e tu të jenë të caktuar të votojnë në vendvotimin më të afërt me shtëpinë e tyre
- Të flasësh me miqtë e tu në lidhje me rëndësinë e të qenit SUPERAKTIV/E, sidomos duke votuar në çdo palë zgjedhje
- Të shfrytëzosh atë që mëson në këtë udhërrëfyes, të informosh familjen e miqtë për proceset zgjedhore, e sidomos çështjet kyçe si përfaqësimi, procesi i votimit dhe mënyrën për të plotësuar fletëvotimin siç duhet.



DOBIA E PUNËS NË ZGJEDHJE:

- ✓ Ti mund të kontribuosh drejtpërdrejt në proceset zgjedhore, duke shërbyer si zyrtar/e zgjedhor/e, e përmes këtyre pozitave të luash rolin e duhur në sigurimin e një procesi të sigurt dhe legjitim.
- ✓ Mund të fitosh përvojë në zgjedhje, si dhe varësisht nga pozita, mund të përforcosh aftësi të shumta, si ato menaxhuese, komunikuese, si dhe aftësi për punë nën presion.
- ✓ Mund të takosh njerëz të rinj dhe të zgjerosh rrjetin tënd.

Dëshiron të dish më shumë se si organizohen zgjedhjet në Kosovë, si dhe çfarë roli do të mund të kishe? Shko tek INKUBATORI I NJOHURIVE PËR SUPERNDRYSHUES, Pjesët 2 dhe 3, faqet 47 dhe 50.

Përkrahja për aktivitete që promovojnë zgjedhjet e drejta dhe të lira

Përkrahja për aktivitete që promovojnë zgjedhjet e drejta dhe të lira Gjatë periudhës së fushatës, në ditën e zgjedhjeve dhe gjatë përpilimit të rezultateve zgjedhore, organizatat e shoqërisë civile bëjnë vëzhgimin e pavarur të procesit zgjedhor, për të vëzhguar nëse të gjitha palët në zgjedhje po zbatojnë rregullat. Ato vëzhgojnë aktivitete si fushatat zgjedhore dhe vendvotimet në ditën e votimit. Ky është aktivitet në të cilin marrin pjesë qytetarët SUPERAKTIVË.

Mund të bëni një kurs trajnimi në internet (në anglisht) mbi parimet e vëzhgimit të zgjedhjeve në faqen e OSBE/ODIHR-it. Në periudhën e zgjedhjeve, mund të aplikoni për t'u bërë vëzhgues i zgjedhjeve, si dhe të trajnoheni mbi të gjitha aspektet e vëzhgimit të zgjedhjeve në Kosovë.

Nëse je votues, mund të përkrahësh integritetin e zgjedhjeve duke raportuar tek Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa, me dëshmitë përkatëse për shkeljet e mundshme të rregullave zgjedhore që i shihni.

Dëshiron të dish më shumë për masat e mbrojtjes së integritetit të zgjedhjeve? Shko tek masat për mbrojtjen e integritetit të zgjedhjeve tek INKUBATORI I NJOHURIVE TË SUPERNDRYSHUESVE, Pjesa 4, në faqen 60.

SA MË SHUMË TË DISH, AQ MË E EFEKTSHME DO TË JETË PJESËMARRJA JOTE

Mund të gjesh më shumë hollësi për proceset zgjedhore në Kosovë tek INKUBATORI I NJOHURIVE TË SUPERNDRYSHUESVE në këtë udhërrëfyes. Të kuptuarit se si mbahen zgjedhjet do të të ndihmojë të kesh pjesëmarrje të mirëfilltë në zgjedhje dhe të ndihmosh në krijimin e një Kosove më të mirë.

Çdo pjesë e INKUBATORIT TË NJOHURIVE TË SUPERNDRYSHUESVE shpjegon thjeshtë proceset e zgjedhjeve dhe qeverisjes në Kosovë. Pasi të kesh lexuar këto hollësi, ti do të kesh SUPERNJOHURI – plotësisht i përgatitur të jesh SUPERAKTIV. Tregoju miqve se çfarë ke mësuar, ndoshta mund të testoni njëri-tjetrin për SUPERKURORËN e njohurive të zgjedhjeve.

FAZA IV:

NDRYSHUES/E

FAZA E NDRYSHUESIT NË NIVEL MAKRO


Një mënyrë në të cilën mund të ndikosh tek ndryshimi në nivel të Kosovës është duke u angazhuar vazhdimisht në procese politike, ose përmes subjekteve politike ose përpjekjeve individuale. Të dy opsionet mund të të çojnë drejt pozitave të lidhshme, përmes të cilave mund të ndikosh tek politikat që formësojnë jetën e të gjithë qytetarëve në Kosovë.

Angazhimi në politikë

Subjektet politike ekzistojnë për të mbledhur bashkë zërat e qytetarëve me ide të afërta ashtu që të mund të ndikojnë në rrugën e zhvillimit të shoqërisë. Zërat e shumë qytetarëve që veprojnë bashkë janë më të fortë se ai i një qytetari që qëndron vetëm.

Subjektet politike shërbejnë si mjet i demokracisë përfaqësuese, duke afruar lidhjen mes njerëzve dhe shtetit.

Qëllim madhor i një subjekti politik është që të garojë në zgjedhje, me synimin e fitimit të ulëseve të mjaftueshme për të formuar apo për të qenë pjesë e qeverisë, si dhe për të arritur përmbushjen e vizionit të atij subjekti politik për shoqërinë. Për të arritur këtë, subjekti duhet të përafrojë një spektër të gjerë njerëzish, e për ta bërë këtë, ndoshta duhet të bëjë kompromise në vizionet e tij.



A E KENI DITUR?

Termi "subjekt politik" ashtu siç përdoret në Kosovë nuk është sinonim i "partisë politike".

Subjektet politike janë parti politike të regjistruara, grupe interesi të njerëzve me ideale të ngjajshme, iniciativat qytetare, e kandidatë individual, qëllimi madhor i të cilëve është të garojnë në zgjedhje.


Do të ishte tejte e rrallë që një subjekt politik të reflektojë saktësisht çdo gjë që ti dëshiron apo që beson.

Megjithatë, nëse vendos t'i bashkohesh një subjekti politik që ka politika që përgjithësisht janë të ngjashme me qëndrimet tua, mund të punosh brenda subjektit politik për të provuar të ndryshosh politikat e tij, ashtu që të afrohen më shumë me ato që ti do. Kjo mund të jetë e vështirë, të marrë shumë kohë, si dhe kërkoj diskutimin dhe bindjen e të tjerëve që qëndrimet e tua përbëjnë politika më të mira për atë subjekt politik.

Në gjithë botën, e sidomos tek të rinjtë, ekziston një masë e shkëputjes nga subjektet politike ekzistuese, një ndjenjë që ato nuk i ofrojnë qytetarëve atë që ata kërkojnë. Por, këtë mund ta ndryshoni, si dhe të keni ndikim tek orientimi dhe politikat e subjektit politik, vetëm nëse i bashkoheni atij: nuk mund të keni ndonjë ndikim të madh nga jashtë.

Nëse beson që qëndrimet tuaja janë vizion i dallueshëm për shoqërinë, që nuk përputhen me asnjë prej subjekteve politike ekzistuese, si dhe që mund të bindësh mjaft njerëz që qëndrimet e tua janë rruga e duhur për Kosovën, mund të formosh subjektin tënd politik. Këtë mund ta bëni duke rekrutuar një grup njerëzish me qëndrime të përafëta apo thjesht ju mund të garoni si kandidat i pavarur për zgjedhje.

Dëshiron të dish më shumë për subjektet politike në Kosovë dhe çfarë bëjnë ato? Shko tek INKUBATORI I NJOHURIVE TË SUPERNDRYSHUESVE, pjesa 5, faqja 63.




Hyrja në organizatë të shoqërisë civile (OSHC)

Organizatat e shoqërisë civile (OSHC), të quajtura edhe organizata joqeveritare (OJQ), janë grupe të qytetarëve që bashkohen për të avokuar për një kauzë të përbashkët, apo për të shtyrë përpara çështje specifike. Ato mund të kenë bazë të gjerë, ose të fokusohen në çështje specifike, siç janë mjedisi, të drejtat e gruas, mundësitë për personat me aftësi të kufizuara, të drejtat e refugjatëve, apo çështjet e shërbimet në një zonë specifike lokale.

OSHC-të synojnë të ndikojnë tek opinioni publik, shpesh përmes ngritjes në sipërfaqe të çështjeve të ndryshme, ofrimit të informatave e analizave për ato çështje, duke krijuar kështu ndikimin tek qeverisja dhe institucionet shtetërore.

Pasi që ka shumë OSHC, aktivitetet e të cilave fokusohen tek çështjet specifike, mund të jetë më e lehtë të gjejsh një OSHC që ka qëndrime të përafërta me tuat për një çështje. OSHC-të gjithashtu mbledhin zërat e qytetarëve me ide të përafërta, ashtu që të mund të ndikojnë në evoluimin e shoqërisë. Zëri yt mund të forcohet, kur bashkohet me të tjerët në një OSHC.



Krijimi i ndikimit

Ti mund të kesh ndikim nëse shënjestron me kujdes institucionet dhe aktivitetet në të cilat mund të kesh kontribut të drejtpërdrejtë në vendimet që përcaktojnë drejtimit e Kosovës. Më poshtë janë disa shembuj.

KUVENDI I KOSOVËS

- Ti mund t'i shkruash Deputetëve apo të caktosh takime me ta.
- Ti mund të marrësh pjesë në dëgjime publike që organizohen nga komisionet e Kuvendit, të cilët ftojnë palët e interesuara që të diskutojnë për projektligjet e propozuara.
- Ti mund të nisësh fushata në media sociale për të avokuar pro apo kundër një projektligji të posaçëm.
- Ti mund të organizosh peticione për nisma legjislativë, ose peticione në përkrahje ose në protestë kundër një ligji të veçantë.

QEVERIA E KOSOVËS

- Ti mund të marrësh pjesë në konsultime publike të organizuara nga ministritë e caktuara.
- Ti mund të marrësh pjesë në grupe punuese që hartojnë ligje, strategji, plane veprimi, rregullore e të ngjashme.
- Ti mund të vëzhgosh mbledhjet e grupeve punuese, ku mund të paraqesësh mendime të diskutosh.
- Ti mund të caktosh takime me zyrtarë qeveritarë për të avokuar për çështje specifike.
- Ti mund të ftosh zyrtarë qeveritarë në organizime të ndryshme si panelistë apo pjesëmarrës, ku mund të avokoni për çështje specifike.

PRESIDENCA

- Ti mund të dërgosh peticione e kërkesa për çështje të caktuara.
- Ti mund të ftosh Presidentin/ten në organizime të ndryshme, ku mund të avokosh për çështje të caktuara.
- Ti mund të fillosh fushata në media sociale për të theksuar ndonjë çështje për vëmendjen e Presidentit/tes.

A E KENI DITUR?

Mund të përforconi sistemin e drejtësisë duke raportuar rastet e korrupsionit apo krimin të dyshuar ku keni qenë dëshmitar, ose duke dëshmuar në gjykatë.

PUSHTETI LOKAL – KUVENDI I KOMUNËS DHE KRYETARI

- Ti mund t'i shkruash Kryetarit apo këshilltarëve komunalë ose të caktosh takim me ta.
- Ti mund të marrësh pjesë në grupe punuese komunale që hartojnë politika, apo mund të vëzhgosh mbledhjet e grupeve punuese, ku mund të marrësh pjesë në diskutime.
- Ti mund të marrësh pjesë në dëgjime publike që organizohen nga Kryetari apo komitetet komunale.
- Ti mund të nisësh fushata në media sociale për të avokuar pro apo kundër një aktiviteti të caktuar komunal.
- Ti mund të organizosh peticione për të iniciuar një veprim, apo në përkrahje apo në protestë kundër aktiviteteve të caktuara komunale.
- Ti mund të vëzhgosh të gjitha seancat plenare të Kuvendit Komunal dhe komiteteve.

Monitorimi i aktivitetit të përfaqësuesve të zgjedhur dhe pushtetit qendror e lokal

Ndërmjet zgjedhjeve, mund të merrni pjesë në forume publike, diskutime e aktivitete të tjera për të monitoruar se çfarë bëjnë përfaqësuesit tuaj. Thjesht duke përcjellur aktivisht raportet mediale të aktiviteteve të përfaqësuesve të zgjedhur, mund të keni njohuri për atë që bëhet nga përfaqësuesit, si dhe të ngreni zërin nëse mendoni që do të duhej të shërbenin më mirë për komunitetin tuaj.

Ngjashëm, mund të vëzhgoni se çfarë bëjnë qeveria shtetërore dhe ajo lokale, por edhe institucionet tjera qendrore dhe komunale. Sa të efektshme e të sinqerta janë institucionet që zbatojnë politikat e tyre në punën e tyre? A po ndërmerren veprime për të zbatuar politikat e premtimet që qeveria vendore apo komunale kanë bërë?

Mund të vëzhgoni si pjesëtar i OSHC-ve, duke kontribuar në ngritjen e vetëdijes nga OSHC-të, raportimin apo avokimin. Ose, mund të vëzhgoni si individ, si dhe t'i bëni të njohura rezultatet e monitorimit përmes postimeve në media sociale.


Dëshiron të dish më shumë për institucionet e qeverisjes në Kosovë me të cilat mund të kesh kontakt e t'i monitorosh? Shko tek **INKUBATORI I NJOHURIVE TË SUPERNDRYSHUESVE**, Pjesa 6, faqe 65.

FAZA V:

NDRYSHUES/E SOCIAL

FAZA E ZHVILLUESIT/ES TË KOMUNITETIT

Shpesh Superndryshuesit duan të punojnë larg vëmendjes, e të ndryshojnë komunitetin hap pas hapi. Ata shfrytëzojnë aftësitë dhe kohën e tyre, shpesh në mënyrë vullnetare, për të përmirësuar jetën e pjesëtarëve të komunitetit të tyre. Më poshtë janë dhënë disa nga hapat që Superndryshuesit bëjnë për të iniciuar e zbatuar aktivitete e projekte që janë thelbësore për zhvillimin e komunitetit.



HAPI

1

IDENTIFIKIMI I ÇËSHTJES

- Zbulo një apo dy çështje që kanë rëndësi për ty, si dhe që janë në fushën e interesimit dhe njohurive tua.
- Zhvillo një analizë problemi, që i përgjigjet tri pyetjeve kryesore:
 - 1) Pse është ky problem?
 - 2) Për kë është ky problem? dhe
 - 3) Pse duhet të zgjidhet?
- Hulumto për çështjen(t) e zgjedhura, si dhe mëso më shumë nga argumentet, statistikat e raportet.

HAPI

2

HULUMTIMI I ZGJIDHJEVE TË MUNDSHME

- Hulumto idetë për përballjen me një çështje. Ka mundësi që dikush në botë ka bërë diçka të ngjashme, nga e cila mund të mësoni apo të frymëzoheni.
- Konsultohu me palët e përfshira, që kanë njohuri në atë fushë, si dhe që kanë vullnetin të të ndihmojnë. Nëse fiton përkrahjen e tyre në hartimin dhe zbatimin e projektit, projekti do të jetë më i fuqishëm dhe më i suksesshëm.

HAPI

3

IDENTIFIKO QËLLIMET DHE OBJEKTIVAT E PROJEKTIT

- Duhet ta kesh të qartë se cili është ndryshimi që dëshiron të shohësh dhe ta arrish në periudhën afatmesme dhe atë afatgjatë.
- Qëllimi duhet të jetë një deklaratë më e gjerë, që është frymëzuese dhe përcakton rrugën drejt asaj që dëshiron të arrish në afat të gjatë.
- Objektivat tua duhet të jenë deklarata specifike që përshkruajnë atë që dëshiron të arrish në periudhën afatmesme.
- Objektivat duhet të jenë SMART, që përfshin elementet vijuese:

Shembull i një qëllimi: Rini aktive në Kosovë
Shembull i një objektive: 100 gra e burra të rinj iniciojnë aktivitete në komunitetin e tyre brenda 5 vitesh.

- S – specifike e të qarta
- M – të matshme me njësi matëse specifike
- A – të arritshme brenda periudhës së projektit
- R – Realiste
- T – Temporale – të kenë periudhë kohore specifike.

IDENTIFIKO SPECIFIKAT E PROJEKTIT

- Projekti duhet të ketë informata të hollësishme, me aktivitete, kornizë kohore, burime (njerëzore, vendi për organizime, materiale, emjete të tjera), si dhe buxhet.
- Aktivitetet duhet të jenë efektive e kreative. Para se të gjithash, ti je i/e ri, i/e mençur e kreativ/e, si dhe e di më së miri se për çka ka nevojë komuniteti yt. Aktivitetet duhet të marrin parasysht nevojat e grupit shënjestër, për të cilët hartohet projekti.
- Periudha kohore duhet të jetë realiste. Projekti duhet të zhvillohet duke marrë parasysht kohën që ti dhe ekipi yt do të kenë për zbatim të projektit, si dhe sa do të duhet për të kryer punë në rrethanat në të cilat punoni.
- Ekipi yt është përbërësi kryesor për hartimin dhe zbatimin e një projekti të suksesshëm. Duhet të punosh me njerëz që kanë të njëjtën energji e pasion për ndryshimin që do të shohësh, si dhe që kuptojnë plotësisht projektin dhe rolin e tyre në të.
- Buxheti është ai që mbështet projektin që do të zbatosh, edhe pse disa aktivitete mund të bëhen vullnetarisht dhe pa fonde. Kur zhvillon buxhetin, duhet të jeni realistë në kuptimin e asaj që nevojitet dhe sa mund të kushtojë. Është gjithmonë mirë për ndjenjën e pronësisë, si dhe për rritjen e mundësive që projekti juaj të pranohet, të keni kontribute direkte nga ju dhe nga përkrahësit që mund të afroni.

HAPI

5

ZHVILLO PLANIN E MONITORIMIT E VLERËSIMIT

- Plani i monitorimit dhe vlerësimit ndihmon në matjen e progresit në zbatim të aktiviteteve dhe vlerësimin e rezultateve të projektit.
- Monitorimi është aktivitet i vazhdueshëm që duhet të bëhet gjatë gjithë projektit, derisa vlerësimi mund të bëhet në momente të caktuara (në mes apo në fund të projektit), ku projekti vlerësohet për një periudhë të caktuar kohore.
- Treguesit (indiktorët) tuaj janë njësi matëse kuantitative, përmes të cilëve mund të monitorosh e vlerësosh projektin.
- Caqet (targetet) janë rezultatet që vendosen për treguesit, të cilat do të arrini deri në fund të projektit.

SHEMBULL TREGUESI (INDIKATORI):

- Numri i njerëzve që marrin pjesë në ngjarje,
- Numri i kopjeve të këtij udhërrëfyesi që shpërndahen tek të rinjtë/ të rejat.

SHEMBUJ CAKU (TARGETI):

- 100 njerëz marrin pjesë në ngjarje,
- 100,000 kopje të udhëzuesit të shpërndara tek të rinjtë/ të rejat

....
HAPI

6

IDENTIFIKO BURIMET E MUNDSHME

○ Burimet tua do të jenë thelbësore për hartimin dhe zbatimin e projektit. Burimet mund të përfshijnë donatorë të mundshëm që do të financojnë projektin, kompani të mundshme që mund t'ju ofrojnë përkrahje, vullnetarë, e të tjerë.

○ Tani që ke identifikuar çështjen që do ta trajtosh, si dhe ke ide për projekt për adresimin e kësaj çështje, e edhe planin për zbatim, monitorim dhe vlerësim të tij, vetëm të duhet të hulumtosh kush financon aktivitete të tilla, e kush mund të ndihmoj në zbatimin e tyre.

KËSHILLË: Fol për idenë tënde me këdo që njeh. Dikush që e njeh ti mund të ofrojë ndihmë, ose mund ta njoh dikë që ka vullnet për të mbështetur. Nëse flet me pasion, dikush do të dëgjojë e të vijë në përkrahje.

....
HAPI

7

KTHEJE IDENË NË
PROJEKT-PROPOZIM

○ Ideja jote është përbërësi kryesor i projekt-propozimit. Pjesa e mbetur është çështje formatimi, si dallimi ndërmjet poezisë e prozës.

○ Çdo donator ka kritere specifike mbi atë se si i duan propozimet e tyre, bashkë me udhëzimet mbi shkrimin e tyre. Thjesht shkruajeni idenë sipas udhëzimeve të tilla.

....
HAPI

8

BIND TË TJERËT QË T'JU PËRKRAHIN

- Gjithçka lidhet me "shitjen" e idesë. Ka rëndësi që ta mendosh mirë idenë, si dhe të jesh në gjendje ta shpjegosh para të tjerëve për 30 sekonda, me shumë pasion e vetëbesim.
- Mbi të gjitha, duhet të besosh në idenë tënde, pasi që besimi do të reflektojë në prezantimin tënd. Nëse ti nuk beson në idenë tënde, kush do ta besojë?

....
HAPI

9

IMPLEMENTO PROJEKTIN

- Ke arritur të kthesh idenë e mirë në projekt, si dhe të bindësh të tjerët të besojnë e të përkrahin. Tash, duhet të zbatosh planin për të implementuar aktivitetet që ke dizajnuar, brenda periudhës kohore dhe buxhetit që ke planifikuar.
- Nganjëherë, për shkak të faktorëve të jashtëm, aktivitetet mund të mos realizohen sipas planit. Kjo është në rregull dhe ndodh. Vetëm mendo shpejt e në mënyrë kreative se si të përshtatesh me rrethanat e reja.

HAPI

10

VLERËSO PROJEKTIN

Urime! Ke implementuar një projekt të suksesshëm që ka sjellë ndryshime në komunitetin tënd. Tash, vlerëso projektin në bazë të caqeve dhe treguesve që ke vendosur, si dhe shih çfarë ka funksionuar e çfarë do të funksiononte më mirë herën tjetër.

Këto informata përdori kur të hartosh projektin e radhës.



FAZA VI:

SUPERNDRYSHUES/E

FAZA E SUPERFUQIVE NË FORCË TË PLOTË

Vullneti për të përmirësuar komunitetin dhe superfuqitë që ke, të bëjnë Superndryshuesin/en që je. Ti do të shfaqesh vullnet në çdo gjë që bën, duke përfshirë leximin e këtij udhërrëfyes. Krejt çka të duhen janë superfuqitë tuaja, që janë burimi i pikave të forta. Pasi të kesh zbuluar superfuqitë tuaja, si dhe të kesh përmirësuar ato që mund të përmirësohen, ti je i/e gatshëm/me të përdorësh ato superfuqi me intensitet të plotë për të arritur ndryshimet që dëshiron të shohësh.



SFIDË PERSONALE



**Inicio një aktivitet brenda komunitetit tënd
në tre muajt në vijim.**

Bind **5 miq** të të bashkohen.

Mund të jetë çfarëdo – pastrimi i parkut të lagjes, takimi me bashkëmoshatarë për aktivizëm rinor e zhvillim, apo avokimi për një çështje duke organizuar takime me këshilltarët e Kuvendit Komunal. Çdo gjë!

BËJE.

Më poshtë është dhënë lista e superfuqive që të bëjnë më të fortë. Sa më shumë superfuqi të kesh nga lista si më poshtë, aq më i/e fortë je si Superndryshues/e. Të gjitha këto superfuqi mund të mësohen vetë, ose me trajnime e kurse. Mund të zhvillosh ato superfuqi nëse dëshiron. Krejt varet nga ti.

MENYJA E SUPËRFUQIVE TË SUPERNDRYSHUESVE

Aftësia për të punuar nën presion	Afërsi	Qëndrim pozitiv
Saktësia	Gatishmëri	Zgjidhje e problemeve
Përshtatshmëria	Pavarësi	Të folurit publik
Shkathtësi analitike	Integritet	Shpejtësi në mësim
Vëmendje për detaje	Lidership	Lexim
Përkushtim	Aftësi dëgjimi	Besueshmëri
Aftësi komunikimi	Besnikëri	Gjindshmëri
Zgjidhje e konflikteve	Mentorim	Respekt për të tjerë
Kreativitet	Ndjeshmëri ndaj kulturave	Përgjegjshmëri
Mendim kritik	Gjindshmëri	Vetë-besim
Vendosmëri	Aftësi negocimi	Vetë-motivim
Ndjeshmëri	Këmbëngultësi	Lojtar ekipi
Entuziazëm	Bindje	Vullnet për mësim
	Planifikim	Shkrim

Vërejtje: Superfuqitë mund të barten nga puna në punë si dhe nga projekti në projekt.

 Superndryshues/e,

Cilat janë superfuqitë tua? _____

Çfarë aktivitete do të kryesh me superfuqitë tua? _____

○ URIME!



○ TASHMË JE
SUPERNDRYSHUES/E!
~~~~~

○ ME MEZI PRESIM PËR TË PARË SE SI DO TA BËSH  
KOMUNITETIN E GJITHË KOSOVËN VEND MË TË  
MIRË.

○ TË FALEMINDERIT PARAPRAKISH PËR SHËRBIMIN TËND,  
**KOSOVA**





**UDHËRRËFYESI I  
SUPERNDRYSHUESVE**  
PËR ZHVILLIM TË KOMUNITETIT



# INKUBATORI I NJOHURIVE TË SUPERNDRYSHUESVE

## Përgatit superfuqitë tua për Kosovën

### PJESA 1: KORNIZA PËR ZGJEDHJE

Mënyra e mbajtjes së zgjedhjeve në Kosovë përcaktohet me Kushtetutë, ligjet e Kosovës, rregulloret dhe udhëzimet e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), si dhe rregulloret e institucioneve të tjera.

### KUSH ANGAZH OHET NË ZGJEDHJE NË KOSOVË?

Zgjedhjet nuk ndodhin thjesht rastësisht. Një numër i madh institucionesh, organizatave dhe njerëzve duhet të punojnë ngushtë për të pasur zgjedhje të suksesshme. Rolet kryesore mbahen nga:

- Presidenti/ja i/e Kosovës** ► Shpall zgjedhjet
- Subjektet politike dhe kandidatët e tyre** ► Garojnë në zgjedhje
- Votuesit** ► Votojnë për partitë dhe njerëzit që i përfaqësojnë, në mënyrë që të sigurojnë lidhshmëri legjitime
- Komisioni Qendror i Zgjedhjeve** ► Administrojnë zgjedhjet nga niveli qendror deri te ai komunal e deri tek vendvotimi
- Paneli Zgjedhor për Ankesa e Parashtresa (PZAP)** ► Shqyrton ankesat dhe parashtresat zgjedhore
- Policia e Kosovës, Prokuroria e Kosovës** ► Zbulojnë dhe përndjekin veprat penale kundër zgjedhjeve
- Vëzhguesit e zgjedhjeve** ► Vëzhgojnë mbajtjen e zgjedhjeve dhe raportojnë mbi shkeljet e mundshme
- Mediat** ► Raportojnë për fushatën zgjedhore dhe administrimin e zgjedhjeve

## LLOJET E ZGJEDHJEVE NË KOSOVË

Votuesit në Kosovë zgjedhin përbërjen e Kuvendit të Kosovës (parlamentit të Kosovës) përmes zgjedhjeve të drejtpërdrejta në mbarë Kosovën. Ata gjithashtu zgjedhin kuvendet komunale dhe kryetarët e komunave përmes zgjedhjeve të drejtpërdrejta të mbajtura në secilën komunë.

Presidenti/ja i/e Kosovës gjithashtu zgjedhet, por nga deputetët e Kuvendit të Kosovës dhe jo drejtpërdrejt nga votuesit.

## METODAT E VOTIMIT PËR ZGJEDHJE TË DREJTPËRDREJTA NË KOSOVË

Metoda e votimit për zgjedhjet e Kuvendit të Kosovës, për zgjedhje për kuvende komunale dhe për kryetar të komunës janë të ndryshme.



## ZGJEDHJA E SUBJEKTIT DHE KANDIDATIT POLITIK

Për zgjedhjet e Kuvendit të Kosovës, votuesit marrin një fletëvotim.

Fletëvotimi përmban listën e subjekteve politike në anën e majtë, si dhe kutitë me numra që i përgjigjen numrave të kandidatëve në anën e djathtë.

Për zgjedhje komunale, votuesit marrin dy fletëvotime.

Fletëvotimi për zgjedhjet e Kuvendit Komunal përmban listën e subjekteve politike në anën e majtë, si dhe kutitë me numra që i përgjigjen numrave të kandidatëve në anën e djathtë.

Fletëvotimi për zgjedhje të Kryetarit të Komunës përmban subjektin politik dhe emrin e kandidatit në anën e majtë.

## SI PËRCAKTOHEN REZULTATET E ZGJEDHJEVE

Zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës dhe Kuvendin Komunal kanë Sistem Proporcional Përfaqësimi me Lista të Hapura. Kjo do të thotë që çdo subjekt politik fiton një numër ulësesh në një kuvend, që është afërsisht ekuivalent me proporcionin e numrit total të votave të vlefshme në zgjedhje.

Në sistemin proporcional të përfaqësimit me lista të hapura që përdoret në Kosovë, nëse një subjekt politik fiton  $x$  ulëse, kandidatët nga ai subjekt me  $x$  numrin më të lartë të votave marrin ato ulëse. Megjithatë, kriteri në Kosovë është që së paku 30% të përfaqësuesve të secilit subjekt politik duhet të jenë nga secila gjini dhe ky është kriter obligues, i cili duhet të aplikohet edhe në ndarjen e ulësve për kandidatë.



### KËNDI I INFORMATAVE

Ka mënyra të ndryshme të kalkulimit se sa ulëse ka fituar secili subjekt politik në sistemin e përfaqësimit proporcional, disa prej të cilave janë matematikisht të ndërlikuara.

Në Kosovë, përdoret metoda e quajtur Sainte-Laguë. Kjo është titulluar sipas emrit të matematikanit francez André Sainte-Laguë, i cili ka zhvilluar formulën më 1912. Mund të kuptoni më shumë për këtë duke kërkuar 'Sainte-Laguë' në internet.

Rezultatet e zgjedhjeve për Kryetar Komune përcaktohen me një sistem me dy raunde. Nëse kandidati për Kryetar merr 50%+1 votë, ai/ajo zgjedhet që në raundin e parë. Nëse asnjë nga kandidatët për Kryetar nuk merr 50% + 1 votë në raundin e parë, dy kandidatët me numrin më të lartë të votave garojnë në raundin e dytë të zgjedhjeve. Kandidati/ja që merr numrin më të madh të votave zgjedhet si kryetar/e komune.

## **TIPARE TË RËNDËSISHME QË DUHET TË DINI PËR ZGJEDHJET E KUVENDIT TË KOSOVËS DHE ATO TË KUVENDIT TË KOMUNËS**

Elementet themelore të sistemit të zgjedhjeve për Kuvend të Kosovës dhe Kuvend Komunal karakterizohen sipas disa tipareve të rëndësishme, që ndikojnë në numrin e përfaqësuesve që fiton secili subjekt politik në kuvend, sa përfaqësues do të ketë, si dhe cilët kandidatë zgjedhen.

### **ZGJEDHJET PËR KUVEND TË KOSOVËS**

- **Kuota gjinore prej 30%** - e cila siguron që së paku 30% e kandidatëve të secilit subjekt politik dhe përfaqësuesve të zgjedhur të Kuvendit të jenë gra, si dhe së paku 30% të jenë meshkuj
- **Ulëset e garantuara për komunitete pakicë** - nga 120 ulëset në Kuvend, 10 janë të garantuara për pjesëtarët e komunitetit serb, si dhe 10 për pjesëtarët e komuniteteve tjera pakicë.
- **Pragu 5% për subjektet politike** - do të thotë se subjekti politik duhet të fitojë së paku 5% të votave të vlefshme për të pasur të drejtë të fitojë ulëse përfaqësuese në Kuvend. Subjektet politike që përfaqësojnë komunitetet pakicë nuk kanë nevojë të përmbushin këtë kriter.
- **S'ka transferim automatik të votës për subjektin politik tek kandidati** - nëse votuesi zgjedh një subjekt politik, por jo kandidatin, në fletëvotim, vota numërohet vetëm si votë për subjektin politik.

**ZGJEDHJET  
PËR  
KUVEND  
KOMUNAL**

- **Kuota gjinore prej 30%** - e cila siguron që së paku 30% e kandidatëve të secilit subjekt politik dhe përfaqësuesve të zgjedhur të Kuvendit të jenë gra, si dhe së paku 30% të jenë meshkuj
- **Nuk ka ulëse të garantuara për komunitetet pakicë**
- **Nuk ka prag votash për subjektet politike**
- **Transferimi automatik i votës së subjektit politik tek kandidati** - nëse votuesi zgjedh një subjekt politik, por jo kandidatin në fletëvotim, vota numërohet për subjektin politik dhe për kandidatin numër 1 (bartësin/en i/e listës) në listën e kandidatëve të subjektit.

**FAKT ARGËTUES: KUOTA GJINORE NUK ËSHTË KUOTË GRASH. AJO MUND TË VLEJË EDHE PËR BURRA NËSE KANË PËRFAQËSIM TË DOBËT NË ZGJEDHJE**

## KUR SHPALLEN ZGJEDHJET:

Subjektet politike zgjedhin kandidatët e tyre si dhe caktojnë renditjen që do të paraqitet në listën e kandidatëve për zgjedhje.

- Deri në 110 kandidatë për Kuvendin e Kosovës
- Një numër i caktuar i kandidatëve për Kuvendin Komunal, varësisht nga numri total i anëtarëve të Kuvendit Komunal, i cili përcaktohet sipas numrit të popullsisë së secilës komunë.
- Së paku një në tre kandidatë në listë duhet të jetë i gjinisë tjetër.
- Një kandidat/e për Kryetar/e në secilën Komunë

### A E KENI DITUR?

Gara është e hapur për 100 ulëse në Kuvendin e Kosovës, ndërsa 20 ulëse të tjera garantojnë për përfaqësues të komuniteteve pakicë. Subjektet politike mund të nominojnë deri në 110 kandidatë për Kuvend të Kosovës. Kjo siguron që të ketë zëvendësues të mjaftueshëm për deputetët që japin dorëheqje ose marrin pozita qeveritare gjatë mandatit të Kuvendit.

### DISA FAKTE TË DOBISHME PËR ADMINISTRIMIN ZGJEDHOR NË KOSOVË

Që nga momenti kur Presidenti/ja shpall zgjedhjet, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka afat mes 4 deri në 6 muaj që të organizojë zgjedhjet në rastin e zgjedhjeve të rregullta, si dhe 30 deri në 45 ditë në rast të zgjedhjeve të jashtëzakonshme.

Organizimi i zgjedhjeve është detyrë e madhe. Kërkohet prokurimi dhe shpërndarja e pajisjeve e materialeve, ofrimi i informatave e edukimit për votues, menaxhimi i sistemeve kompjuterike që ndihmojnë në menaxhimin e zgjedhjeve, rekrutimi dhe trajnimi i mijëra zyrtarëve, mirëmbajtja strikte e cilësisë dhe kontrollet e integritetit në çdo aktivitet zgjedhor, si dhe funksionimi i mijëra vendvotimeve.

**Kjo është struktura e administrimit të zgjedhjeve në Kosovë. Ku mendon që mund të kesh një rol?**

#### Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

- Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka 11 anëtarë - Kryetari/ja i/e cila vjen nga Gjykatës Supreme, emëruar nga Presidenti i Kosovës; 6 anëtarë/e që emërohen nga grupet parlamentare më të mëdha të komunitetit shumicë në Kuvendin e Kosovës; si dhe 4 anëtarë/e që emërohen nga grupet parlamentare që mbajnë ulëset e rezervuara për komunitete pakicë në Kuvend.
- KQZ-ja merr vendime dhe harton politika, të cilat zbatohen nga Sekretariati.
- Gjatë periudhës zgjedhore, Sekretariati angazhon personel të përkohshëm për të ndihmuar në aktivitetet zgjedhore, si logjistika, trajnime, si dhe regjistrim të rezultateve të zgjedhjeve nga vendvotimet.



## 38 Komisione Komunale Zgjedhore

- Komisionet Komunale Zgjedhore (KKZ) emërohen për periudhën zgjedhore dhe janë autoritetet më të larta zgjedhore në nivelin komunal.
- KKZ-të zakonisht kanë 7 anëtarë/e: Zyrtari/ja Komunal/e për Zgjedhje, që është punëtor/e i/e përhershëm/me i/e KQZ-së dhe është Kryetari/ja i/e KKZ-së, si dhe anëtarë/e të tjerë/a që emërohen nga subjektet politike që kanë kaluar pragun zgjedhor në zgjedhjet paraprake të përgjithshme, ose janë nga subjektet politike të komuniteteve pakicë.
- Përtej periudhës zgjedhore, Zyrtari/ja Komunal/e i/e Zgjedhjeve menaxhon proceset zgjedhore në komunë.

## 798 Qendra Votimi

- Qendrat e votimit (QV-të) janë vende ku votuesit shkojnë për të votuar. Ato janë kryesisht shkolla. Çdo qendër votimi ka një apo më shumë vendvotime.
- Personeli përgjegjës për logjistikën dhe informimin e përgjithshëm për qendrën e votimit, që përfshin Menaxherin/en e Qendrës së Votimit, Asistentin/en e Qendrës së Votimit, si zyrtarët/et i/e Tavinës Ndhmëse, zgjedhet nga tërësia e personelit shkollor. Menaxheri/ja i/e Qendrës së Votimit është zakonisht drejtori/eshja i/e shkollës.

## 2374 Vendvotime

- Vendvotimet (VV) janë sallat ku votuesit votojnë. Ato janë kryesisht klasa.
- Personeli i Komisionit të Vendvotimit emërohet nga subjektet politike, organizatat joqeveritare, e nganjëherë edhe KKZ-të.
- Pasi të miratohet lista e stafit, KKZ-ja i cakton këta njerëz në pozita të ndryshme në Komisionet e Vendvotimit (Kryetar/e, anëtarët/et e vendvotimit, si dhe zyrtarët/et rezervë të vendvotimit) në vendvotime të caktuara për të siguruar përfaqësimin e subjekteve politike të ndryshme në një vendvotim.

## POZITAT E PERSONELIT ZGJEDHOR

Në vijim janë disa prej pozitave të personelit zgjedhor, në të cilat mund të angazhohesh:

| Pozita zgjedhore                                | Metoda e rekrutimit                                                                       | Përshkrimi i pozitës                                                                                                                        |
|-------------------------------------------------|-------------------------------------------------------------------------------------------|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| Kryetar/e i/e Komisionit                        | Nominimi nga subjektet politike, organizatat joqeveritare, apo personeli zgjedhor komunal | Përgjegjës për rregullsinë e procesit të votimit në Vendvotim.                                                                              |
| Anëtar/e i/e Komisionit të Vendvotimit          | Nominimi nga subjektet politike, organizatat joqeveritare, apo personeli zgjedhor komunal | Përgjegjësitë janë si në vijim: Kontrollues Rendi, Zyrtar Identifikues, Lëshues i Fletëvotimit, Mbikëqyrës i Kutisë së Votimit.             |
| Rezervë në Komisionin e Vendvotimit             | Nominimi nga subjektet politike, organizatat joqeveritare, apo personeli zgjedhor komunal | Nëse anëtarët apo kryetari/ja nuk paraqiten në Vendvotim për ndonjë arsye, zyrtari/ja rezervë i/e Vendvotimit zë vendin e tij/saj.          |
| Menaxher/e i/e Qendrës së Votimit               | Rekrutim i drejtpërdrejtë nga KQZ-ja – zakonisht drejtorë/eshë shkollash                  | Mbikëqyr procesin e votimit në Qendrën e Votimit.                                                                                           |
| Asistent/e i/e Qendrës së votimit               | Rekrutim i drejtpërdrejtë nga KQZ-ja – zakonisht punëtorë/e të shkollës                   | Udhëzon votuesit sipas nevojës, sidomos në gjetjen e vend votimit të tyre.                                                                  |
| Zyrtar/e i/e Tavolinës Ndihmëse                 | Rekrutim i drejtpërdrejtë nga KQZ-ja zakonisht punëtorë/e të shkollës                     | Ndihmon votuesit të gjejnë emrin në listën e votuesve.                                                                                      |
| Personel në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve | Rekrutim i drejtpërdrejtë nga KQZ-ja – me konkurs                                         | Varësisht nga pozita, mund të jetë në pranim të kutive të votimit, shënim të dhënash, auditim, ndërlidhje me palët e përfshira, e të tjera. |

**MOS HARRO!!**



Sigurohu që kur të shpallen zgjedhjet, si dhe gjatë periudhës zgjedhore, të kontrollosh ueb faqen e KQZ-së për të parë se për çfarë pozitash mund të aplikosh.

Nëse dëshiron të jesh zyrtar/e në një vendvotim, zakonisht duhesh të nominoresh për këtë punë nga dega lokale e një subjekti politik, pra duhet të kontaktosh subjektin që zgjedh.

### PJESA 3: ÇFARË BËN ADMINISTRATA ZGJEDHORE?

Ka aktivitete të shumta që i ngarkojnë organet e administratës zgjedhore, sidomos në periudhat pak përpara, gjatë dhe menjëherë pas ditës së zgjedhjeve.

**A ka ndonjë prej këtyre proceseve që ti mendon se mund të ndihmohet?**

#### AKTIVITETET PARA DITËS SË ZGJEDHJEVE

##### Certifikimi i subjekteve dhe kandidatëve politikë

- Të gjitha subjektet politike duhet të jenë të certifikuara për të garuar në zgjedhje. Nëse subjekti politik tashmë është certifikuar në zgjedhjet e mëparshme, do të përfshihet automatikisht në listën e subjekteve të certifikuara, nëse ato nuk kërkojnë diçka tjetër. Nëse dy apo më shumë subjekte politike që janë certifikuar më herët formojnë një koalicion para-zgjedhor, atëherë duhet të certifikohen si koalicion.
- Secili subjekt politik duhet t'i nënshtrohet procesit të certifikimit të kandidatëve që garojnë për pozita të ndryshme, duke përfshirë kandidatët për deputetë, kandidatët për anëtarë të kuvendit komunal si dhe kandidatët për Kryetar Komune.
- Pasi të jenë certifikuar subjektet politike dhe kandidatët, KQZ-ja printon fletëvotimet për zgjedhje.

## Fushata e informimit publik

- Në çdo palë zgjedhje, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve organizon fushatën informuese për të informuar votuesit se si të votojnë, si dhe t'i motivojnë ata që ta bëjnë këtë.
- KQZ-ja duhet t'i kushtojë vëmendje të posaçme motivimit të grupeve që kanë më pak gjasë të votojnë – si gratë, të rinjtë dhe komunitetet rurale e ato pakicë, që të votojnë.
- KQZ-ja duhet të sigurojë që votuesit të jenë të informuar për konceptet kryesore, siç është sigurimi i saktësisë së të dhënave të regjistrimit të votuesve; data, vendi dhe koha e votimit; si të plotësohet fletëvotimi ashtu që vota të jetë e vlefshme; si numërohen votat, si dhe shërbimet e ofruara nga KQZ-ja.

## Finalizimi i listës së votuesve

- Lista e votuesve krijohet nga ekstrakti i regjistrimit civil që i dërgohet KQZ-së nga Agjencia e Regjistrimit Civil. KQZ-ja i caktton votuesit në vendvotime në bazë të kësaj liste.
- Votuesit mund të kërkojnë të ndërrojnë vendvotimin e tyre gjatë periudhës së specifikuar, por pasi KQZ-ja të ketë marrë ekstraktin e listës së votuesve nga Regjistri Civil, votuesit nuk mund të ndryshojnë detajet tjera të tyre në listën e votuesve.
- KQZ-ja krijon listën unike të votuesve për çdo vendvotim. Para ditës së zgjedhjeve, listat shpërndahen në të gjitha komunat dhe qendrat e votimit, bashkë me materialet tjera të ndjeshme.

## Rekrutimi dhe trajnimi i personelit zgjedhor

- Për çdo proces zgjedhor, KQZ-ja rekruton deri në 19,000 njerëz për zgjedhje, me rekrutim të drejtpërdrejtë dhe të tërthortë.
- Personeli i përkohshëm për KQZ-në, Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve, trajnerët dhe stafi teknik rekrutohen drejtpërdrejt, ose përmes konkurseve të hapura, ose duke rekrutuar nga stafi i shkollës, në rastin e stafit teknik.
- Anëtarët e Komisionit të Vendvotimit rekrutohen me anë të nominimit nga subjektet politike dhe organizatat joqeveritare. sipas nevojës, edhe KQZ-ja mund të rekrutojë persona për këto pozita.
- I gjithë personeli zgjedhor i nënshtrohet trajnimeve specifike për të shërbyer në pozitë përkatëse.

## Akreditimi i vëzhguesve

- Para Ditës së Zgjedhjeve, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve akrediton vëzhguesit zgjedhorë vendorë dhe ndërkombëtarë, përmes aplikacioneve nga organizatat. Shumica e aplikacioneve bëhen nga subjektet politike.
- KQZ-ja gjithashtu akrediton vëzhgues nga mediat.

## AKTIVITETET E DITËS SË ZGJEDHJEVE

Para se të shkosh që të votosh, Komisionet e Vendvotimit duhet të rregullojnë Vendvotimin. Të gjitha materialet jo të ndjeshme – të tilla si: mjetet e zyrës, kabinat e votimit dhe pajisjet – shpërndahen tek Qendrat e Votimit një natë para Ditës së Zgjedhjeve, si dhe rregullohen Vendvotimet. Në çdo Qendër Votimi, Vendvotimi i fundit është i dyfishtë, ku mund të votohet edhe me kusht (vota nga votuesit që nuk janë në listën e votuesve të Qendrës së Votimit). Në atë vendvotim të dyfishtë, ka dy lloj kutish për vota – njëra për votat e rregullta dhe tjetra për ato me kusht.

Herët në mëngjesin e Ditës së Zgjedhjeve, Kryetari/ja i/e Komisionit të Vendvotimit dhe Menaxheri/ja i/e Qendrës së Votimit shkojnë në depon komunale për të marrë materialet sensitive – që janë ruajtur nën siguri strikte, të cilat pastaj i dërgojnë në qendrat e tyre të votimit dhe vendvotime.

### Materiali sensitiv

- ▶ Lista finale e votuesve
- ▶ Fletëvotimet
- ▶ Vulat zyrtare të fletëvotimit
- ▶ Lampa ultra vjollce
- ▶ Broshurat e Kandidatëve
- ▶ Shiritat e sigurisë
- ▶ Ngjyra e padukshme (sprej)

### Material jo-sensitiv


- ▶ Kutia e votave
- ▶ Kabina e votimit
- ▶ Ngjyra dhe sfungjerat e ngjyrës
- ▶ Libri i votimit
- ▶ Shiritat mbyllës të sigurisë

//

**Tashmë, të gjithë janë gati që votimi të fillojë.**

//

## PROCESI I VOTIMIT



**Figura 1. Rregullimi i vendvotimit**

Të gjitha vendvotimet duhet të rregullohen në mënyrë që të jenë të qasshme për personat me aftësi të kufizuar.


Në Ditën e Zgjedhjeve, ti si votues mundesh me votu në periudhën prej orës 7:00 deri në ora 19:00.

Pasi të hysh në Qendrën e Votimit, mund të shkosh drejtpërdrejt te vendvotimi yt. Nëse ke vështirësi ta gjesh vendvotimin tënd, Zyrtari/ja i/e Tavolinës Ndihmëse do të ndihmojë.

### A E KENI DITUR?

Të gjitha votat e rregullta numërohen në vendvotime. Nëse vërehet ndonjë parregullsi në regjistrat e numërimit, ose PZAP-ja urdhëron KQZ-në që të bëjë rinumërimin e kutisë së votave, rishikimet dhe rinumërimet bëhen në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve (QNR). Të gjitha votat me kusht dhe ato me postë numërohen drejtpërdrejt në QNR.

## SI FUNKSIONON PROCESI I VOTIMIT ?





## NUMËRIMI I VOTAVE

Në ora 19:00 vendvotimet mbyllen, si dhe fillon detyra e rëndësishme e numërimit të të gjitha votave të rregullta që janë hedhur në atë vendvotim.

Numërimi bëhet nga anëtarët e Komisionit të Vendvotimit, vëzhgohet nga vëzhguesit e organizatave të pavarura dhe subjekteve politike. Pasi të jenë numëruar të gjitha votat, informatat shënohen në formularët zyrtarë të rezultateve, kontrollohen nëse janë të sakta, si dhe formularët duhen nënshkruar nga anëtarët e Komisionit të Vendvotimit. Një kopje e formularit të rezultateve vendoset jashtë secilit Vendvotim, ashtu që të jetë publik.

Pasi të kryhet numërimi i votave, Kryetari/ja i/e Vendvotimit mbyll dhe bllobon materialet e votimit, plotëson raportet për to, si dhe përcjell kutitë e votimit deri tek vendi ku pranohen materialet e kthyer nga vendvotimet nga Komisioni Komunal Zgjedhor. Kutitë e votave që paraqiten me parregullsi shenjohe.

Shumë herët në mëngjesin e ardhshëm, Kryetarët e Komisioneve Komunale Zgjedhore marrin të gjitha materialet nga çdo Qendër e Votimit në komunat përkatëse, si dhe i dërgojnë tek Qendra e Numërimit dhe Rezultateve. Kjo është një ditë e gjatë e punës për zyrtarët e zgjedhjeve.



## PROMOVIMI I TRANSPARENCËS

Sistemi K-vote i KQZ-së, me bazë tableti, përdoret për të bartur tek KQZ-ja rezultatet e numërimit të votave për partitë politike, sapo që formularët e rezultateve të finalizohen në vendvotime. Rreth 90% të rezultateve të vendvotimeve regjistrohen përmes K-votës deri në orën 23 në ditën e zgjedhjeve, si dhe publikohen në faqen e KQZ-së. Kjo gjë ofron të dhëna të hershme jozyrtare për rezultatet e zgjedhjeve, si dhe mund të jetë masë mbrojtëse kundër përpjekjeve të mëvonshme për manipulim. Rezultatet nga K-vote nuk janë zyrtare; vetëm votat e regjistruara pas Ditës së Zgjedhjeve në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve janë rezultate zyrtare për certifikim.

K-vote gjithashtu përdoret për të transmetuar të dhëna progresive të daljes në zgjedhje nga çdo vendvotim gjatë ditës së zgjedhjeve, ashtu që të mund të identifikohen turmat e pazakonshme në votim.

## AKTIVITETET PAS DITËS SË ZGJEDHJEVE

Pas Ditës së Zgjedhjeve, fokusi është tek përcaktimi i rezultateve të zgjedhjeve, duke siguruar që këto rezultate të jenë të sakta, si dhe që procesi i certifikimit të rezultateve të pranohet nga të gjitha subjektet politike dhe votuesit e Kosovës. Formularët e rezultateve përpunohen në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve, e cila funksionon 16 deri në 24 orë në ditë, 7 ditë në javë, deri sa të finalizohen të gjitha rezultatet. Disa qindra punëtorë të përkohshëm menaxhojnë dhe ndihmojnë këtë proces.

Të gjitha materialet e vendvotimeve që dërgohen në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve pas Ditës së Zgjedhjeve kontrollohen me kujdes, ndërsa kutitë e votimit nga çdo Vendvotim në të cilët dokumentacioni përcjellës ka pasaktësi të dukshme ndahen anash për hetime të mëtejshme.

Formularët e rezultateve dhe listat e shënuara të votuesve nga vendvotimet përpunohen brenda një databaze: formularët e rezultateve, me shifra të dyfishta, si dhe listat e votuesve me anë të skenimit të bar-kodit afër secilit votues që ka nënshkruar listën si votues.

Shifrat nga formularët e rezultateve pastaj kontrollohen për ndonjë parregullsi apo mospërputhje. Kur nuk ka parregullsi apo mospërputhje, toaletet e votave për subjektet politike dhe secilin kandidat/e nga formulari i rezultateve përmbledhen në total të komunës, ndërsa për zgjedhjet e kuvendit të Kosovës, mbledhen edhe në nivel të totalit të vendit. Në rast të parregullsive në formularë rezultatesh, bëhet hetimi i thuktë, që mund të rezultojë me rinumërim të urdhëruar nga KQZ-ja. Kutitë e votimit mund të rinumërohen edhe sipas vendimit të PZAP-së sipas ankesës.

Pasi që formularët e rezultateve për të gjitha votat e rregullta të jenë përpunuar, si dhe të dhënat të përmbledhen, zarfat me votat me kusht, votat nga kutitë mobile të votave, si dhe votat me postë që janë pranuar nga jashtë Kosovës verifikohen, zarfat hapen dhe votat brenda tyre numërohen.

Pasi që të gjitha rezultatet e votave të rregullta dhe votave tjera të përmbledhen dhe hulumtimet dhe rinumërimet në QNR të kryhen, përgatitet numërimi i plotë i rezultateve zgjedhore që të shpallen nga KQZ-ja. Pasi PZAP-ja të ketë vendosur për ankesa, si dhe të jenë kryer rinumërimet që janë urdhëruar nga PZAP-ja në QNR, dhe të bëhen korrigjimet e nevojshme në rast nevoje, KQZ-ja mund të certifikojë rezultatet zgjedhore si përfundimtare.

## SI E SIGURON KQZ-JA SAKTËSINË E REGJISTRIMIT TË REZULTATEVE?

Nëse zbulohen parregullsi në dokumentacionin përcjellës për kutitë e pranuar, këto i raportohen KQZ-së, e cila pastaj mund të vendosë që të rinumërohet, apo të anulohet një kuti votimi.

Të dhënat nga formularët e rezultateve shënohen në një databazë nga dy ekipe të pavarura, si dhe çdo dallim ndërmjet shënimeve të ekipeve hetohet nga një ekip i posaçëm.

Mospërputhjet aritmetike në formularët e rezultateve që gjenden gjatë shënimit të të dhënave dërgohen për auditim special dhe hetim. Nëse mospërputhjet nuk rregullohen, ato raportohen tek KQZ-ja, që mund të vendosë që kutia e votimit të rinumërohet.

Gjurmët e auditimit në databaza të shqyrtuara rregullisht përdoren për të zbuluar përpjekjet për qasje të paautorizuara apo për ndryshim të të dhënave të rezultateve.

Subjekti politik dhe vëzhguesit tjerë janë të pranishëm në numërimin e rezultateve. Nëse një subjekt politik apo kandidat beson që numërimi i votave është i pasaktë, ose që përpunimi në QNR ka qenë i pasaktë, mund të parashtrojë ankesë në PZAP, e cila pastaj hulumton votat e caktuara, ose udhëzon KQZ-në të bëjë rinumërimin.

## **VËZHIMI I ZGJEDHJEVE**

Të qenit vëzhgues i zgjedhjeve është mënyrë e shkëlqyeshme që të kesh njohuri për proceset zgjedhore. Vëzhguesit luajnë rol të madh në mbrojtje kundër parregullsive e mashtrimeve, duke siguruar që rezultatet e zgjedhjeve të jenë të pranueshme për njerëzit në Kosovë.

Një numër organizatash të shoqërisë civile në Kosovë kanë mision vëzhgues të zgjedhjeve, ndërsa disa prej tyre përmbledhin përpjekjet e tyre për të ofruar mbulim maksimal të zgjedhjeve – siç është koalicioni i organizatave jo-qeveritare Demokracia në Veprim. Fokusi i vëzhgimit të zgjedhjeve nga ky koalicion i OJQ-ve është tek vendtimi në ditën e zgjedhjeve, por disa vëzhgues mund të angazhohen për të mbuluar aktivitetet e fushatave politike apo numërimin e rezultateve të zgjedhjeve.

Për të pasur qasje në vendotim apo aktivitete tjera në zgjedhje, vëzhguesi duhet të jetë i akredituar nga KOZ-ja. Vëzhguesit kanë të drejta e detyrime të përcaktuara me ligjin e zgjedhjeve, dhe rregullat e KOZ-së, si dhe duhet të zbatojnë një kod strikt etike. Të drejtat e vëzhguesve përforcojnë transparencën e zgjedhjeve, duke mundësuar qasje në vëzhgimin e proceseve zgjedhore. Detyrimet e tyre i obligojnë që të jenë dhe të kenë paraqitjen e paanësisë së plotë, si dhe të mos ndërhyjnë e të mos ndikojnë në asnjë mënyrë në zgjedhje.

Nëse je i/e interesuar të jesh aktivist/e në subjektin politik, mund të kërkesish mundësinë për të qenë vëzhgues/e në emër të subjektit të preferuar politik. Ky është rol ndryshe nga ai i vëzhguesit të pavarur, siç është edhe i fokusuar tek mbrojtja e interesave të subjektit politik dhe kandidatëve të tij.

## ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE ZGJEDHORE

Në Kosovë, ekzistojnë dy organe që merren me mosmarrëveshjet zgjedhore dhe shkeljet e ligjit të zgjedhjeve.



Policia e Kosovës dhe prokurorët janë të vendosur afër Qendrave të Votimit në Ditën e Zgjedhjeve për të trajtuar shpejt të gjitha veprat penale që mund të ndodhin. Qasja në gjykatat e Kosovës për veprat penale të zgjedhjeve kufizohet tek policia dhe prokurorët e Kosovës.

► Çdo votues/e i/e regjistruar në Kosovë mund të parashtrojë ankesë zgjedhore tek Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP).

Paneli Zgjedhor për Ankesa e Parashtresa pranon ankesa në katër faza:

- Ankesat ndaj vendimeve të KQZ-së,
- Ankesat gjatë periudhës parazgjedhore,
- Ankesat për shkelje në Ditën e Zgjedhjeve,
- Ankesat gjatë periudhës paszgjedhore.

Nëse je votues/e, mund të parashtrosh ankesë tek PZAP-i për shkeljet e rregullave të zgjedhjeve në të cilat je dëshmitar/e. Ky është faktor i rëndësishëm në ruajtjen e ndershmërisë dhe integritetit të zgjedhjeve. Nëse e sheh që rregullat zgjedhore janë thyer – raporto. Shkeljet e rregullave zgjedhore mund të lëndojnë procesin demoraktik, si dhe të rrënojnë vullnetin e popullit në Kosovë.

Në faqen e saj të internetit, PZAP-i ka një publikim të hollësishëm për shkeljet zgjedhore dhe parashtimin e ankesave zgjedhore. Ky proces i ankimit është përmbledhur shumë shkurt në diagramin e mëposhtëm.

**Kush mund të parashtrojë ankesë në PZAP?**

Të gjithë votuesit/et e regjistruar të Kosovës, përfaqësuesit/et e subjekteve politike, Komisioni i Vendvotimit, si dhe vëzhguesit/et lokal/e.

**Kur mund të parashtrohet ankesë?**

Gjatë fushatës zgjedhore: deri në 72 orë pas shkeljes

Në ditën e zgjedhjeve: deri në 24 orë pas mbylljes së vendvotimeve

**Si mund të parashtrohet ankesë?**

Plotësoje formularin që e shkarkon në faqen e PZAP-it, ose që mundesh me marrë personalisht në PZAP, dhe dorëzo personalisht në zyrën e PZAP-it në Prishtinë

**Kur duhet PZAP-i të marrë vendim për ankesën?**

PZAP ka 72 orë për të marrë vendimin.

**Çfarë vendimesh mund të marrë PZAP-i?**

Aprovim i ankesës - nëse ka dëshmi solide

Refuzim i ankesës - nëse nuk ka dëshmi solide, dhe

Hedhje poshtë e ankesës - nëse është dorëzuar pas afatit.

Sigurohu që të zbatosh saktë udhëzimet për plotësimin formularit dhe bashkëngjit të gjitha dokumentet përcjellëse

Mund të përcjellësh progresin e ankesave në trajtim nga PZAP-i dhe vendimet që PZAP ka marrë mbi ankesat në ueb faqen e PZAP-it.

## PJESA 5: SUBJEKTET POLITIKE

Kosova është republikë parlamentare që ka sistem shumëpartiak, ku ka disa subjekte politike që garojnë në zgjedhje dhe kanë mundësi të fitojnë pozita udhëheqëse.


Subjektet politike janë partitë politike, grupet e interesit/iniciativat qytetare, si dhe kandidatët individualë.

Për t'u certifikuar për garim në zgjedhje, mes kërkesave tjera, subjektet politike duhet të dorëzojnë listën e nënshkrimeve të përkrahësve:

- o 100 nënshkrime nga votues të regjistruar kur garohet në zgjedhje komunale dhe
- o 1000 nënshkrime nga votues të regjistruar kur garojnë në zgjedhje të përgjithshme.

### *Partitë politike*

Partitë politike janë organizata me struktura specifike që synojnë të marrin pushtet duke fituar vota në zgjedhje. Struktura e partive mund të jetë:



Shumica e partive politike kanë forume rinore dhe forume të gruas, të cilat janë organe të partive politike që përfaqësojnë ato grupe specifike, si dhe hartojnë politika partiake për adresimin e çështjeve me të cilat këto grupe përballen.



Partitë e regjistruara politike kanë një numër detyrimesh që përcaktohen në ligjin e Kosovës. Këto janë:

- Të pasurit e së paku 500 anëtarëve që jetojnë në Kosovë e që janë të shënuar në listën e votuesve të Kosovës
- Të pasurit e një statuti që rregullon punët e veta të brendshme
- Pajtimi për të zbatuar Kodin Etik të Partisë Politike
- Programi që definon synimet dhe aktivitetet politike të partisë
- Regjistrimi dhe raportimi i rregullt mbi financat e saj

Pasi të regjistrohet, partia politike nuk ka nevojë të regjistrohet prapë, por ka nevojë të përditësoj informatat e saj. Megjithatë, partitë politike duhet të certifikohen për të garuar në zgjedhje.

#### *Grupet e interesit/nismat qytetare*

Ndryshe nga partitë politike, Grupet e interesit/nismat qytetare jo detyrimisht kanë strukturë apo synojnë të marrin pushtetin. Përgjithësisht, synimi i tyre kryesor është të ndikojnë në politika dhe në politikë. Megjithatë, mund të zgjedhin të garojnë edhe në zgjedhje, nëse duan.

#### *Kandidatët e pavarur*

Edhe individët mund të certifikohen si subjekte politike dhe mund të garojnë në zgjedhje. Deri tash, ka pasur kandidatë të pavarur që kanë garuar për pozitën e Kryetarit/es të Komunës apo anëtarit/es të Kuvendit Komunal, si dhe kanë fituar. Megjithatë, pragu prej 5% për të fituar ulësen në Kuvendin e Kosovës që vlen edhe për kandidatët e pavarur është i vështirë të kalohet, që është edhe arsyeja pse kandidatët ngurrojnë të kandidojnë si të pavarur për këto pozita.

## PJESA 6: INSTITUCIONET E QEVERISJES NË KOSOVË

### KUVENDI I KOSOVËS

Kosova është republikë parlamentare me sistem shumë partiak, ku ka disa subjekte politike që garojnë në zgjedhje dhe kanë mundësi të marrin pozita udhëheqëse. Kuvendi i Kosovës përbëhet nga përfaqësues të zgjedhur nga qytetarët e Kosovës në Zgjedhje për Kuvend të Kosovës.

#### Hyrje

- Është pushtet ligjvënës në Kosovë.
- Është i vetmi institucion qendror që zgjedhet drejtpërdrejt nga populli.
- Ka 120 anëtarë apo deputetë.

#### Përgjegjësitë

- Miraton ligje, rezoluta e akte të tjera ligjore
- Ratifikon traktate e marrëveshje ndërkombëtare
- Zgjedh Kryetarin/en dhe Nënkryetarët/et e Kuvendit, Presidentin/en e Kosovës, Kryeministrin/en e Kosovës, si dhe shefat e agjencive të pavarura.
- Mbikëqyr punën e qeverisë dhe 36 agjencive të pavarura.

#### Struktura

- **Kryesia e Kuvendit të Kosovës:** bashkërendon programin e punës së Kuvendit. Përbëhet nga Kryetari/ja dhe 5 deputetë/e të tjerë, që shërbejnë si nënkryetarë/e të Kuvendit të Kosovës.
- **Kryetari/ja i/e Kuvendit të Kosovës:** Drejton seancat plenare, interpreton rregulloren e punës, si dhe përfaqëson Kuvendin.
- **Komisionet Parlamentare:** përfshin komisionet e përhershme (përgjegjëse për shqyrtimin e gjithë legjislacionit nga fushëveprimtaria e tyre), komisionet funksionale (përgjegjëse për shqyrtimin e

legjislacionit vetëm në fusha specifike), si dhe komisionet ad-hok (të krijuara për çështje specifike, si dhe që shqyrtojnë vetëm legjislacionin në lidhje me çështjen për të cilën krijohen).

- **Grupet parlamentare:** kanë së paku 6 Deputetë/e që përfaqësojnë grupe specifike, siç janë subjektet politike, rininë dhe gratë.

## Legjislacioni

- **Projektligjet mund të propozohen nga:**
  - 1) Presidenti i Kosovës,
  - 2) Qeveria e Kosovës,
  - 3) Deputetët e Kuvendit të Kosovës (së paku 6 deputetë),
  - 4) Komisionet parlamentare
  - 5) Grupet parlamentare, si dhe
  - 6) Qytetarët mbi 18 vjeç përmes peticioneve (me 10,000 nënshkrime).
- Miratimi i ligjeve në Kuvend bëhet me shumicë të thjeshtë të votave të Deputetëve të Kuvendit. Megjithatë, ka ligje të veçanta që kërkojnë 2/3 e votave, ose nganjëherë 2/3 e votave të përgjithshme si dhe 2/3 e të gjitha votave të Deputetëve të Kuvendit nga komunitetet pakicë.
- Ligji pastaj nënshkruhet nga Kryetari/ja i/e Kuvendit dhe i dërgohet Presidentit/es të Republikës së Kosovës për dekretim. Presidenti/ja mund ta kthejë ligjin në Kuvend vetëm një herë, bashkë me arsyetim.

## QEVERIA E KOSOVËS

### Hyrje

- Është degë ekzekutive në Kosovë.
- Presidenti/ja i/e Kosovës, në konsultim me subjektin/kodicionin që ka fituar shumicën në Kuvend, propozon kandidatin/en për Kryeministër/e.
- Kandidati/ja për Kryeministër/e dhe kabineti i tij/saj duhet të votohet nga shumica e deputetëve të Kuvendit të Kosovës.
- Qeveria e Kosovës i raporton Kuvendit të Kosovës përmes raporteve në seanca plenare, komisione parlamentare, si dhe raporteve me shkrim.

### Përgjegjësitë

- Harton projektligje dhe zbaton ligjet e aprovuara nga Kuvendi.
- Miraton akte nënligjore të nevojshme për zbatim të ligjeve.
- Propozon buxhetin e Kosovës.
- Udhëheq dhe menaxhon administratën publike të Kosovës, si dhe misionet diplomatike të Kosovës.
- Menaxhon autoritetet e sigurisë në Kosovë.

### Struktura

- **Kryeministri/ja i/e Republikës së Kosovës:** Udhëheq kabinetin ekzekutiv dhe bashkërendon punën e ministrive në përputhje me programin qeverisës, përfaqëson Qeverinë e Kosovës, brenda dhe jashtë, si dhe emëron pozita të caktuara në qeveri dhe agjenci të tjera.
- **Zëvendëskryeministrat e Kosovës:** Ndihmojnë Kryeministrin/en në përgjegjësitë e tij/saj, si dhe këshillojnë Kryeministrin/en në fusha specifike.
- **Ministrat e Kosovës:** udhëheqin sektorë specifike, hartojnë dhe zbatojnë ligjet specifike, miratojnë akte nënligjore, si dhe raportojnë para Kuvendit të Kosovës për punën në sektorët e tyre. Ministrat zakonisht

udhëheqin “ministri”, që përbëhet nga shërbyes civilë që zbatojnë politikat qeveritare në fushën e përgjegjësisë së ministrit.

- Agjencitë e pavarura të Qeverisë së Kosovës: organe qeveritare me kompetenca të posaçme për të zbatuar vetëm ligje të caktuara.

## SISTEMI I DREJTËSISË

### Hyrje

- Sistemi i drejtësisë përbëhet nga gjykatat (themelore, të apelit dhe supreme) si dhe prokuroria. Policia e Kosovës ndihmon sistemin e drejtësisë duke hetuar rastet.
- Gjykatat menaxhohen nga Këshilli Gjyqësor, derisa prokuroria udhëhiqet nga Këshilli Prokurorial.
- Gjykata Kushtetuese qëndron jashtë sistemit gjyqësor, pasi që funksionon si e pavarur. Ajo është autoriteti përfundimtar për interpretimin e legjislacionit, si dhe vendimeve të qeverisë dhe gjykatave, në përputhje me Kushtetutën e Kosovës.

### Përgjegjësitë

#### ○ Përgjegjësitë e gjykatave:

- Gjykojnë të gjitha kontestet civile dhe penale.
- Kontestet civile janë: e drejta familjare, e punës, pronësore, ekonomike, e të ngjashme.
- Rastet penale përfshijnë: lëndimet, vrasjet, plaçkitjet, shpëlarjen e parave, krimin e organizuar, trafikimin e njerëzve, korrupsionin, e të ngjashme.

#### ○ Përgjegjësitë e prokurorisë:

- Ndjekja e rasteve penale.
- Në bashkëpunim me Policinë e Kosovës, heton rastet (si vrasje, sulme, trafikimi i drogave).

#### ○ Përgjegjësitë e Gjykatës Kushtetuese:

- Interpreton Kushtetutën për rastet që parashtrihen nga Presidenti, Kuvendi, Komunitet, Qeveria, si dhe Avokati i Popullit.

### o Struktura e gjykatave:

- **Gjykata themelore:** gjykata të shkallës së parë, ku dërgohen të gjitha çështjet për gjykim. Gjykatat Themelore janë themeluar në 7 komunat më të mëdha.
- **Gjykata e Apelit:** Apelet ndaj vendimeve të gjykatave themelore dërgohen në gjykatën e apelit.
- **Gjykata Supreme:** Është organi më i lartë gjyqësor në Kosovë.

### o Struktura e Prokurorisë:

- **Prokurori i Shtetit:** Ka kompetencë të ndjekë penalisht veprat penale.
- **Prokuroria e Apelit:** Instanca e dytë e prokurorisë, që merret me rastet që shkojnë në gjykatë të apelit.
- **Prokuroria Themelore:** Ndjekja e rasteve në instancë të parë. Prokuroritë Themelore janë themeluar në 7 komunat më të mëdha
- **Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës:** Ndjekja penale e krimeve të posaçme, si terrorizmi, gjenocidi, krimet ndaj njerëzimit, krimi i organizuar, shpëlarja e parave.

### o Struktura e Gjykatës Kushtetuese:

- **Kryetari/ja dhe nënkryetari/ja:** Udhëheqin dhe menaxhojnë Gjykatën Kushtetuese.
- **Gjyqtarët:** Interpretojnë Kushtetutën dhe marrin vendime për rastet.

## PRESIDENTI/JA

### Hyrje

- Presidenti/ja është Udhëheqës/e i/e Shtetit dhe përfaqësuesi/ja kryesor i/e politikës së jashtme.
- Përfaqëson unitetin e popullit.
- Zgjedhet nga Kuvendi i Kosovës. Zgjedhja e Presidentit/es mund të bëhet me tri raunde.
- Në dy raundet e para, nevojiten 2/3 e votave të Deputetëve të Kuvendit për të zgjedhur Presidentin/en. Nëse Presidenti/ja nuk zgjidhet në dy raundet e para, ai/ajo mund të zgjedhet në raundin e tretë, me më së paku 61 vota.

### Përgjegjësitë

- Komandant/e Suprem/e i/e Forcës së Sigurisë së Kosovës
- Përfaqëson Kosovën, brenda dhe jashtë
- Nominon kandidatin/en për Kryeministër/e, si dhe emëron e shkarkon disa pozita kyçe, si gjyqtarët, prokurorët, guvernatorët, e të tjerë.
- Mund të propozojë ligje
- Nënshkruan ligjet e miratuara nga Kuvendi

## KRYETARI/JA I/E KOMUNËS

### Hyrje

- Paraqet pushtetin ekzekutiv në nivel komunal.
- Ai/ajo zgjidhet drejtpërdrejt nga qytetarët e Komunës.
- Përfaqëson komunën brenda dhe jashtë vendit.

### Përgjegjësitë

- Udhëheq ekzekutivin dhe administratën e komunës.
- Zbaton rregulloret e miratuara nga Kuvendi I Komunës.
- Propozon rregullore dhe akte të tjera për miratim nga Kuvendi I Komunës.
- Propozon buxhetin komunal dhe planin zhvillimor komunal

## KUVENDI I KOMUNËS

### Hyrje

- Është dega legjislative në nivel komunal
- Numri i anëtarëve në Kuvend Komunal dallon varësisht nga popullsia e komunës.

### Përgjegjësitë

- Aprovon rregulloret komunale
- Mbikëqyr punën e Kryetarit/es dhe kabinetit të tij/saj
- Miraton Buxhetin Komunal
- Cakton taksat, tarifat dhe gjobot komunale
- Shqyrton raportet e auditimit

### Struktura

- **Kryesuesi/ja i/e Kuvendit Komunal:** Moderon seancat plenare të Kuvendit Komunal.
- **Komitetet komunale:** shqyrtojnë rregullore dhe dokumente të tjera dhe japin rekomandime për kuvendin komunal. Numri i komiteteve komunale dallon mes komunave, por dy komitete të përhershme duhet të krijohen në të gjitha kuvendet komunale: Komiteti për Politika e Financa dhe Komiteti për Komunitete.
- **Anëtarët/et e Kuvendit:** Marrin pjesë në seancat plenare të kuvendit komunal, si dhe diskutojnë e votojnë mbi çështjet e kompetencës së Kuvendit Komunal.



# UDHËRRËFYESI I SUPERNDRYSHUESVE PËR ZHVILLIM TË KOMUNITETIT



Nëse dëshironi të dini më shumë rreth proceseve zgjedhore dhe politike në Kosovë, vizitoni faqen e

Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve: [kqz-ks.org](http://kqz-ks.org)

Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtres: [pzap.rks-gov.net](http://pzap.rks-gov.net)

Kuvendit të Kosovës: [kuvendikosoves.org](http://kuvendikosoves.org)

Avokatit të Popullit: [ombudspersonkosovo.org](http://ombudspersonkosovo.org)

Demokracia në Veprim: [demokracianeveprim.org](http://demokracianeveprim.org)

si dhe ueb faqet e subjekteve politike sipas dëshirës suaj

Për të mësuar më shumë rreth zgjedhjeve dhe që të argëtoheni luani Aktivomania në [www.aktivomania.org](http://www.aktivomania.org)





**UDHËRRËFYESI I  
SUPERNDRYSHUESVE**  
PËR ZHVILLIM TË KOMUNITETIT

Prishtinë 2016